

## **K O M E N T**

### **Pershendetje.**

Ne lidhje me interesimin per bilancin e biznesit te vogel do te veçoja:

**Se pari** Ne zbatim te Udh.MF Nr.32 date 31.12.2013 “Për Tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël” kemi

#### **A. Per mbajtjen e regjistrimeve**

7.4. Tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, që realizojnë një qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit, janë të detyruar të mbajnë:

a) librin e shitjeve, ku regjistrojnë në mënyrë kronologjike çdo shitje të kryer me faturë të thjeshtë tatimore si dhe totalin e shitjeve ditore të kryer me kuponë tatimorë;

b) librin e blerjeve, ku regjistrojnë në mënyra kronologjike çdo blerje të kryer me faturë tatimore, me TVSH, me faturë të thjeshtë tatimore;

c) libri i shpenzimeve dhe të ardhurave;

d) librin e aktiveve të biznesit.

7.6 Për tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël që janë të regjistruar në TVSH, libri i shitjeve dhe libri i blerjeve të mbajtura për efekte të TVSH, shërbejnë si të tillë edhe për efekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

(Librat bashkangjitur)

#### **B. Per Deklarimin**

9.1. Të gjithë tatimpaguesit, subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, përfshirë:

tatimpaguesit që realizojnë qarkullim nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit dhe paguajnë katër këste parapagimesh të detyrimit tatimor në vit,

tatimpaguesit që realizojnë qarkullim nga zero deri në 2 milionë lekë në vit dhe paguajnë një shumë fikse detyrimi tatimor në vit,

janë të detyruar që, **brenda datës 10 shkurt** të vitit pasardhës, të **dorëzojnë formularin e “Deklarimit të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin”** për vitin raportues. Deklarata e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin përmban informacion në lidhje me të ardhurat gjithsej, shpenzimet gjithsej, shpenzimet e zbritshme, të ardhurat neto të tatueshme, tatimin për t'u paguar, si dhe informacione të tjera të kërkuara në deklaratë.

**C.** Perfundimisht nga sa me sipër **deri me 10 Shkurt** duhet dorëzuar vetëm **formularin e “Deklarimit të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin”**.

**Se dyti** Në zbatim të ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” kemi:

#### **Neni 4**

1.1. Mikronjësia ekonomike - njësitë ekonomike, që në datën e raportimit **nuk tejkalojnë** kufijtë e të paktën dy prej tri kritereve të mëposhtme:

- a) **aktivi, 15 milionë lekë;**
- b) **të ardhurat** nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), **30 milionë lekë;**
- c) **numri mesatar** i punonjësve gjatë periudhës raportuese, **10.**

#### **Neni 22**

1. **Njësitë ekonomike, brenda 7 muajve** nga data e raportimit, **depozitojnë** për publikim pranë autoritetit përkatës **ku janë regjistruar, pasqyrat financiare vjetore**, raportin e ecurisë së veprimtarisë/raportin e konsoliduar të ecurisë së veprimtarisë, raportin e auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Pra mbi këto baze mikronjësia që nuk tejkalojnë dy nga tre treguesit e mesiperm janë mikronjësia dhe kanë detyrimin ligjor për zbatimin e SKK 15

## **Se treti** Ne zbatim te SKK 15 per Mikronjesite kemi

5. Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha mikronjësitetë ekonomike që realizojnë **jo më pak se 5 milion lekë dhe jo më shumë se 30 milion lekë** të ardhura nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi)

29.Pasqyrat financiare të kërkuara prej mikronjësive, ... janë:

**Pasqyra e shkurtuar e pozicionit financiar;**

**Pasqyra e shkurtuar e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH);**

**Shënimet Shpjeguese të shkurtuara.**

30.Mikronjësitetë , subjekt i zbatimit të këtij Standardi **lejohen** të ndërtojnë edhe pasqyra të tjera me qëllim përmirësimin e transparencës dhe të cilësisë së informacionit që paraqesin (p.sh mund të përfshihet pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe / ose pasqyra e lëvizjes së kapitalit).

Pra mbi kete baze mikronjesite nga 5 deri 30 milion leke xhiro plotesojne bilancin (pasqyrat) mbi sa me siper, ndersa **plotesimi i pasqyrave te fluksit dhe kapitalit jane opsionale** ( nuk kerkohen por lejohen)

**Se katerti** ne zbatim te ligjit 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar kemi:

### **Neni 43 Regjistrimet e tjera të detyrueshme**

1. Çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, **mbart edhe detyrimin** të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe **të depozitojë aktet përkatëse**, si më poshtë:

a) **pasqyrat financiare vjetore**, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme;

Pra mbi kete baze te gjithë subjektet me xhiro mbi 5 milion leke Mikronjesi apo Biznesi i madh, duhet te depozitoje ne QKB pasqyrat financiare brenda 7 muajve (deri me 31 Korrik) neni 22 i ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si me siper.

## **Permbledhja e konkluzioneve**

1. **Deri me 10 Shkurt**, nga te gjithë bizneset me xhiro **0-8 milion** leke, duhet te dorzojne prane DPT-se vetem formularin i “Deklarimit të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin”.

2. Subjektet me xhiro nga **2-5 milion** leke **nuk kane detyrim** te hartojne pasqyra financiare, por **detyrohen te mbajne** librin e blerjeve, te shitjeve, te te ardhurave e shpenzimeve dhe te aktiveve.

3. Subjektet me xhiro **5-30 milion** leke zbatojne SKK 15 dhe hartojne pasqyrat financiare ku detyruese jane

**Pasqyra e shkurtuar e pozicionit financiar;**

**Pasqyra e shkurtuar e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH);**

**Shënimet Shpjeguese të shkurtuara.**

dhe opsionale ( nuk kerkohen por lejohen)

**Pasqyrat e fluksit te mjeteve monetare**

**Pasqyra e levizjes se kapitalit**

4. Subjektet me xhiro **mbi 5 milion** ( biznes i vogel apo biznes i madh, mikronjesi apo jo mikronjesi) **branda dates 31 Korrik** duhet te depozitojne pasqyrat financiare sipas perkatesise ne QKB, ndersa subjektet me tatim fitimi edhe ne DPT.

### **Bashkangjitur**

- Nje montim te shkurter ligjor
- Librat qe percakton udhezimi
- Nje format orientues i bilancit te mikronjesive ne Excel, sipas SKK-se 15 te permiresuar, qe duhet plotesuar duke filluar nga 1 Janari 2019.

Ju faleminderit

Luan Gosnishti

Auditues Ligjor

## **SKK 15 per Mikronjesite**

(Miratuar me Urdherin 56 dt.15.02.2019 te Ministrit te Financave dhe Ekonomise)

5. Ky Standard do të zbatohet nga të gjitha mikronjësitet ekonomike **që realizojnë jo më pak se 5 milion lekë dhe jo më shumë se 30 milion lekë të ardhura nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi)**

29.Pasqyrat financiare të kërkuara prej mikronjësive, subjekt i zbatimit të këtij Standardi, janë:

**Pasqyra e shkurtuar e pozicionit financiar;**

**Pasqyra e shkurtuar e të Ardhurave dhe Shpenzimeve (PASH);**

**Shënimet Shpjeguese të shkurtuara.**

30.Mikronjësitet , subjekt i zbatimit të këtij Standardi lejohen të ndërtojnë edhe pasqyra të tjera me qëllim përmirësimin e transapencës dhe të cilësisë së informacionit që paraqesin (p.sh mund të përfshihet pasqyra e fluksit të mjeteve monetare dhe / ose pasqyra e lëvizjes së kapitalit).

31.Pasqyrat financiare vjetore paraqesin informacionet e mëposhtme:

(a) emrin e mikronjësisë ekonomike dhe të dhëna të tjera identifikuese, si dhendonjë ndryshim në këto të dhëna nga pasqyrat e mëparshme;

(b) datën e ndërtimit të pasqyrave ose periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nëvarësi se cila nga këto është më e përshtatshme;

(c) monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare (lekë);

(d) shkallën e rrumbullakimit të shumave të paraqitura në pasqyrat financiare.

32. Pasqyrat financiare paraqiten dhe publikohen të paktën një herë në vit

57.Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare duhet të jepen shpjegime për çdo grupim të zërave të AAM-ve dhe AAJM-ve në lidhje me vlerën e mbetur në fillim dhe në fund të periudhës duke treguar:

(a) Shtesat;

(b) Daljet jashtë përdorimit;

(c) Amortizimin; dhe

(d) Lëvizje të tjera.

58.Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare përfshijnë gjithashtu:

(a) Përshkrimin e veprimtarisë të mikronjësisë dhe aktivitetin e saj kryesor;

(b) Referencat e standardeve të kontabilitetit të përdorura për të përgatitur pasqyrat financiare;

(c) Shpjegimet mbi politikat kontabël të inventarëve;

(d) Shpjegimet mbi aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara;

(e) Ndonjë informacion tjetër të rëndësishëm për të kuptuarit e pasqyrave financiare.

---

## Ligji 25/2018 date 10.05.2018

### Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare

#### Neni 4

##### **Kategoritë e njësive ekonomike dhe grupeve**

1. Në zbatim të këtij ligji, në varësi të kriterëve që përmbushin, njësitë ekonomike klasifikohen në:

1.1. **Mikronjësi** ekonomike - njësitë ekonomike, që në datën e raportimit nuk tejkalojnë kufijtë e të paktën dy prej tri kriterëve të mëposhtme:

- a) **aktivi, 15 milionë lekë;**
- b) **të ardhurat** nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi), **30 milionë lekë;**
- c) **numri mesatar i punonjësve** gjatë periudhës raportuese, **10.**

5. Kur në datën e raportimit një njësi ekonomike ose grup njësisish ekonomike i tejkalon ose bie nën kufijtë e dy prej tri kriterëve të parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, cenohen klasifikimi sipas këtyre pikave apo standardet kontabël të aplikueshme, **vetëm nëse kjo ndodh për dy periudha raportuese radhazi.**

#### Neni 5

##### **Standardet kontabël që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare**

1. Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, **duhet të zbatojnë SKK**-të për hartimin e pasqyrave financiare.

#### Neni 6

##### **Mbajtja e kontabilitetit**

Të gjitha njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, e organizojnë mbajtjen e kontabilitetit dhe **raportimin financiar** mbi bazën e parimeve dhe metodave **që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit** ose **Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit**, në varësi të standardeve kontabël të aplikueshme.